

KËRKESË

NGA: ALEANCA PËR MBROJTJEN E TEATRIT

DREJTUAR: MINISTRISË SË KULTURËS

PËR DIJENI: KËSHILLI I MINISTRAVE;
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË;
BASHKIA E TIRANËS.

NË VËMËNDJE: PRESIDENTI I REPUBLIKËS

KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT

Pranë Gjykatës Kushtetuese, është zhvilluar konflikti kushtetues me palë ndërgjygjëse:

KËRKUES: PRESIDENTI I REPUBLIKËS.

PALË TË INTERESUARA: KUVENDI I SHQIPËRISË;
KËSHILLI I MINISTRAVE;
MINISTRIA E KULTURËS;
MINISTRIA E FINANCAVE DHE
EKONOMISË;
BASHKIA E TIRANËS.

PALE E TRETË: ALEANCA PËR MBROJTJEN E TEATRIT.

OBJEKTI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, si dhe me Marrëveshjet Ndërkombëtare, të ligjit Nr.37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”;
- Shfuqizimin e Vendimit Nr.377, datë 8.5.2020 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë”, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe me Marrëveshjet Ndërkombëtare;
- Pezullimin e zbatimit të ligjit Nr.37/2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës’ me objekt ‘Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”;

- **Pezullimi e zbatimit të Vendimit Nr.377, datë 8.5.2020** të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin ‘Teatri Kombëtar’, në zonën kadastrale 8150, Tiranë”, **dhe qëllimit të përcaktuar në këtë akt**, derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese, të hyjë në fuqi;
- **Shfuqizimin të Vendimit Nr.50, datë 14.05.2020 të Këshillit Bashkiak, Bashkia Tiranë**, “Për miratimin e shembjes së godinës të “Teatrit Kombëtar”, në pronësi të Bashkisë Tiranë, bazuar në Akt-Ekspertizën e hartuar nga Instituti i Ndërtimit “Mbi vlerësimin e Godinës së Teatrit Kombëtar””, **si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe me Marrëveshjet Ndërkombëtare.**
- **Pezullimin e zbatimit të Vendimit Nr.50, datë 14.05.2020, të Këshillit Bashkiak, Bashkia Tiranë**, “Për miratimin e shembjes së godinës të “Teatrit Kombëtar”, në pronësi të Bashkisë Tiranë, bazuar në Akt- Ekspertizën e hartuar nga Instituti i Ndërtimit “Mbi vlerësimin e Godinës së Teatrit Kombëtar””, **dhe qëllimit të përcaktuar në këtë akt**, derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese mbi këtë çështje të hyjë në fuqi.
- **Pezullimin e zbatimit të çdo akti apo veprimi të çdo autoriteti publik që buron prej ligjit nr.37/2018, VKM-së nr. 377/2020, VKB-së nr. 50, datë 15.5.2020**, derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese mbi këtë çështje të hyjë në fuqi.”

Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.29 datë 02.07.2021, me shumicë votash është vendosur:

“- **Shfuqizimin e Ligjit Nr.37/2018** “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të “Teatrit Kombëtar”, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

- **Shfuqizimin e vendimit Nr.377, datë 08.05.2020 të Këshillit të Ministrave** “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë Nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.”.

Referuar dispozitivit të këtij dispozitivi, ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në flëtoren zyrtare, datë 21.07.2021.

Shpallja antikushtetues e Ligjit Special Nr.37/2018 dhe VKM-së nr.377/2020, ngarkon me përgjegjësi subjektet-palë të interesuara në këtë proces, për ekzekutimin e këtij vendimi, ekzekutim i cili bëhet në referim të dispozitave ligjore që normojnë këtë fushë.

Nisur nga fakti se prona objekt transferimi sipas VKM-së Nr.377 datë 08.05.2020, ka qënë pronë publike e patjetërsueshme e shtetit Shqiptar në përgjegjësi administrimi të organit

qëndror të Ministrisë së Kulturës, para transferimit (pra më datë 07.05.2020), shpallja antikushtetues nga ana e Gjykatës Kushtetuese, i kthen palët në gjëndjen e mëparshme, para datës së transferimit.

Kthimi i palëve në gjëndjen e mëparshme është detyrim ligjor së pari për Ministrinë e Kulturës, me cilësinë e pronares së Teatrit Kombëtar më datë 07.05.2020 (para transferimit), por edhe i subjekteve të tjera të cilat ishin palë të interesuara në këtë proces dhe që me veprimet apo mosveprimet e tyre, i kanë shkaktuar Buxhetit të Shtetit një dëm të konsiderueshëm material dhe publikut një dëm të pallogaritshëm moral në aspekt të Trashëgimisë Kulturore dhe Identitetit Kombëtar.

Nga ana tjetër, Ministria e Kulturës Margariti, nisur nga fakti se ka bërë propozimin antikushtetues për transferimin e pronës, **pasurisë Nr.1/241, me emërtimin “Teatri Kombëtar”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë**, nga Ministria e Kulturës te Bashkia Tiranë, ngarkohet me përgjegjësi direkte për zbatimin e Vendimit Nr.29 datë 02.07.2021 si dhe, çdo pengesë me dashje apo me mosveprime, do të ngarkojë me përgjegjësi të rënda, penale dhe civile në aspektin personal (përpos kallëzimit që kemi bërë ndaj ministres Margariti më 3 korrik 2020 në SPAK).

Në këto kushte, e shohim të domosdoshme dhe urgjente të kërkojmë ekzekutimin e vendimit Nr.29 datë 02.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese, referuar argumentave që ka dhënë kjo gjykatë në raport me:

I- Shpalljen antikushtetues të Ligjit Special Nr.37/2018, bazuar në mbartjen e vlerave të Trashëgimisë Kulturore të Teatrit Kombëtar:

Në analizën që Gjykata Kushtetuese i bën nocionit të identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kulturore (pikat 94-110 të vendimit), Gjykata vëren se identiteti kombëtar dhe Kultura janë përmendur shprehimisht në preambulën Kushtetutës, ku përcaktohet: “Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë.....,

- **me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror,**
- **me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar.....”.**

Gjithashtu, ai, së bashku me trashëgiminë kombëtare garantohet edhe në nenin 3 të Kushtetutës, në të cilin parashikohet:

“Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, **drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë.”**

Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se trashëgimia kulturore është pjesë e trashëgimisë së popullit, si dhe përbën kujtesën e prekshme dhe të paprekshme të asaj që njeriu ka krijuar (dhe vazhdon të krijojë) për pasardhësit e tij.

Sipas Gjykatës, ajo mund të quhet edhe dëshmi materiale që ka vlerën e civilizimit dhe bën pjesë në trashëgiminë kombëtare të një shteti, duke reflektuar jetën e komunitetit, historinë dhe identitetin e tij, si dhe lidhjen e së shkuarës me të tashmen e të ardhmen, si dhe **konsiston në manifestime të jetës njerëzore, që dëshmojnë për vlerat, besimet, historinë dhe traditat e vendit dhe u japin qytetarëve ndjesinë e përkatësisë në një popull, që lidhet më pas me identitetin kombëtar.**

Po kështu, Gjykata argumenton se, mbi identitetin kombëtar, si dhe trashëgiminë kombëtare dhe kulturore detyrimi kushtetues për mbrojtjen dhe respektimin e tyre, i lidhur me parimin e shtetit të së drejtës, **ka të bëjë me marrjen e masave nga ana e ligjvënësit për mbrojtjen e tyre, ashtu dhe me zbatimin në praktikë nga institucionet përkatëse të procedurave ligjore.**

Ashtu si edhe e ka theksuar Gjykata në arsyetim, legjislacioni shqiptar e ka rregulluar trashëgiminë kulturore fillimisht në ligjin Nr. 9048/2003, i shfuqizuar tashmë me ligjin Nr.27/2018, nga ku sanksionohet se **“trashëgiminë kulturore” si tërësinë e pasurive kulturore, materiale dhe jomateriale të një individi, grupi ose shoqërie të trashëguar nga e kaluara që ruhet në të tashmen për t’u përçuar brezave në të ardhmen si pjesë të pasurisë kombëtare të një vendi, të cilat shprehin vlerat, identitetin, njohuritë, traditat, besimet, si dhe pasuritë kulturore të peizazhit** (neni 5, pika 59 e ligjit).

Shprehjet e trashëgimisë kulturore mund të jenë dhe objekte materiale, si monumente ose zona të caktuara. Pasuritë kulturore, në kuptimin e këtij ligji, përbëjnë pronë shtetërore publike (neni 4), **mbrojtja e të cilave konsiston në ndërmarrjen e një sistemi masash me natyrë administrative, juridike, financiare dhe fizike, me qëllim ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, në interesin më të mirë të komunitetit** (neni 5, pika 31 e ligjit).

Sipas Gjykatës, roli që trashëgimia kombëtare zë në Kushtetutë, është e qartë që nëpërmjet ligjit nr. 27/2018 parashikohet një proces ligjor, në themel të të cilit qëndron detyrimi për një vlerësim të veçantë nëse objekte të caktuara hyjnë ose jo në trashëgiminë kulturore.

Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se **ekspertizat që duhet të kryejnë institucionet kompetente për shpalljen e objekteve pjesë të trashëgimisë kulturore ose heqjen e këtij statusi, duhet të jenë objektive, duke treguar një kujdes të shtuar, koherencë në veprime dhe veprime të planifikuara.**

Këto kërkesa që duhet të karakterizojnë vlerësimin e veçantë marrin shkak nga rëndësia që ka identiteti kombëtar dhe trashëgimia kulturore. Prandaj, në rastet e debatueshme në vlerësimet që kryejnë institucionet duhet të **mbizotërojnë interesi për ruajtjen e trashëgimisë kulturore për objektet e deklaruara si të tilla, pra të shterohen të gjitha mjetet dhe mundësitë për të bërë të mundur një gjë të tillë.**

Ndërkohë, Gjykata Kushtetuese konstaton se Teatri Kombëtar ka mbartur cilësi emocionale, shpirtërore dhe kulturore të veçanta në historinë e vendit, si një nga institucionet artistike më të rëndësishme në vend, në të cilin kanë lindur të gjitha institucionet kombëtare të artit skenik dhe edukimit artistik.

Po kështu, Gjykata evidenton se vlerësimi për objektin e Teatrit Kombëtar ka filluar në vitin 2004 kur IMK-ja e ka shpallur monument kulture me shkresën nr. 351 prot., datë 13.5.2004, ndërkohë që vetëm 5 ditë më vonë, me shkresën nr. 356 prot., datë 18.5.2004, e ka deklaruar ndërtesë pa vlerë. Që prej këtij momenti e në vijim ky monument nuk është shpallur më objekt me vlerë kulturore, pavarësisht se është përfshirë 2 herë në mbrojtjen paraprake 6-mujore, në vitin 2015 dhe në vitin 2016.

Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se nuk rezulton qartësisht se cilat kritere mungonin që ky objekt të shpallej me vlerë kulturore, si dhe përse nuk ka mbizotëruar nevoja për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të tij.

Ndonëse Kuvendi ka miratuar një ligj me standarde bashkëkohore për trashëgiminë kulturore, në të cilin parashikohet edhe kriteri kohor i vjetërsisë më shumë se 70 vjet, nuk rezulton të jetë bërë verifikimi i interesit kulturor publik për Teatrin Kombëtar, që është një tregues i mungesës së koherencës së veprimeve të organeve shtetërore.

Po në këtë drejtim, Gjykata çmon se procesi i kryer nga institucionet kompetente ka dhënë rezultate tërësisht të ndryshme në funksion të vlerës kulturore të Teatrit Kombëtar, në një kohë shumë të shkurtër, çka ka përbërë dhe objekt kontrolli e rekomandimesh nga KLSH-ja.

Organet shtetërore nuk janë sjellë në mënyrë koherente, kanë krijuar mosbesim te shteti i së drejtës, si dhe kanë dështuar në kryerjen e procesit të duhur ligjor për procesin e vlerësimit të godinave të Teatrit Kombëtar.

Për rrjedhojë, Gjykata çmon se procesi i ndjekur në lidhje me vlerat historiko-kulturore të godinave të Teatrit Kombëtar si për shkak të historikut të tij, ashtu dhe të përfshirjes në qendrën historike të qytetit të Tiranës, nuk është trajtuar me kujdesin dhe seriozitetin e duhur.

Për të gjitha argumentat ligjorë të arsyetuar në vendimin Nr.29 datë 02.07.2021, Gjykata Kushtetuese vlerëson se Ligji Nr.37/2018 është në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës në raport me nenin 3 të saj, në drejtim të procesit të vlerësimit të identitetit dhe të trashëgimisë kombëtare nga institucionet përkatëse në lidhje me godinën e Teatrit Kombëtar.

Referuar në këtë vendim si dhe në rekomandimet e bëra në vitin 2020 nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, në raportin “Për auditimin e ushtruar në Institutin e Monumenteve të Kulturës”, në të cilin ka konstatuar disa shkelje në veprimtarinë e këtij instituti në lidhje me Teatrin Kombëtar, duke evidentuar gjetjet dhe rekomandimet e tij.

Në këtë raport KLSH-ja rekomandon që procesi i miratimit apo edhe nevoja e ndryshimit ose përcaktimit të kufijve dhe koordinatave të qendrës historike të

qytetit të Tiranës, t'i nënshtrohet një procesi të gjerë e të plotë shqyrtimi dhe diskutimi nga institucionet e përfshira në këtë proces, duke propozuar edhe revokimin e VKM-ve që kanë nxjerrë jashtë kufijve të zonës historike sipërfaqen ku ndodhej ndërtesat e Teatrit Kombëtar.

Në përfundim të këtij rekomandimi, KLSH-ja me vendimin Nr.36 datë 14.05.2020 ka kërkuar pezullimin e Vendimit Nr.50 datë 14.05.2020 të Këshillit Bashkiak për shembjen e Teatrit Kombëtar deri sa çështja të zgjidhet në Gjykatën Kushtetuese (pika 1.) dhe nëse nuk merej në konsideratë ky vendim, **personat përgjegjës, do të mbanin përgjegjësi personale** (pika 2.).

Po kështu KLSH-ja, referuar gjetjeve të realizuar në Institutin e Monumenteve të Kulturës i ka kërkuar kësaj të fundit (në qershor të vitit 2020 KLSH-ja ka disponuar edhe me një kallëzim penal ndaj IMK dhe kjo çështje po hetohet tashmë nga struktura e SPAK), detyrimin e Këshillit të Ministrave dhe Bashkisë së Tiranës, **rindërtimin e godinës së Teatrit Kombëtar në zonën ku kanë qenë godinat e mëparshme, në të njëjtin stil dhe pamje arkitektonike që ka pasur, me të njëjtat volume dhe me të njëjtin projekt** (shih rekomandimin 1.1, f. 152 të raportit).

II- Shpalljen antikushtetues të VKM-së Nr.377/2020, bazuar në komponentët e vlerave si pasuri KOMBËTARE e Teatrit Kombëtar dhe e mbivendosjes me Ligjin Nr.37/2018:

Gjykata vëren se parimi i shtetit të së drejtës (pikat 136-144), në jurisprudencën kushtetuese është trajtuar i lidhur ngushtë edhe me parimin e hierarkisë së akteve normative, duke e konsideruar këtë të fundit si detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Në këtë kuptim, duke qenë se parimi i shtetit të së drejtës i detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese, aktet juridike që nxirren nga organet e pushtetit publik **duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material.**

Nga ana tjetër neni 118, pika 1 i Kushtetutës sanksionon se “aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë”. Ndërsa paragrafi i dytë i këtij neni parashikon se: “ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjen që duhet rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.” Këto dispozita ndihmojnë për t'i dhënë kuptimin kushtetues dhe doktrinar konceptit “rezervë ligjore”, nëpërmjet të cilit kufizohet apo orientohet pushteti normativ i organeve ekzekutive për të rregulluar marrëdhënie të caktuara me akte nënligjore. **Kjo rezervë ligjore krijon mundësinë që çështja konkrete e rregulluar pjesërisht me ligj të mund të detajohet më tej nga aktet nënligjore, duke iu përmbajtur parimeve dhe kufijve të përcaktuar nga ligji.** Vetëm në këtë mënyrë autorizimi i ligjvënësit për nxjerrjen e akteve nënligjore mund të konsiderohet i realizuar brenda kufijve të kushtetutshmërisë.

Gjithashtu, Gjykata argumenton se VKM-ja Nr.377/2020 ka si bazë ligjore për miratimin e saj ligjet Nr.8743/2001 dhe Nr. 8744/2001, **ndërsa për objekt, përveç kalimit të pronësisë Bashkisë së Tiranës të pasurisë Nr. 1/241 me emërtimin “Teatri Kombëtar”, për sipërfaqen prej 5.522,7 (pesë mijë e pesëqind e njëzet e dy pikë shtatë) m², ka edhe ndërtimin e Teatrit Kombëtar si një godine me standarde bashkëkohore, në konsultim me të gjitha grupet e interesit (neni 1 i VKM-së nr. 377/2020).**

Gjithashtu, edhe ligji Nr.37/2018 ka të njëjtin objekt me atë të VKM-së nr. 377/2000, që është ndërtimi dhe dorëzimi i godinës së re të Teatrit Kombëtar (neni 1 dhe neni 2 i ligjit). Në këtë kuptim, edhe pse ligjvënësi ka shprehur vullnetin e tij përmes miratimit të një ligji të posaçëm, që ka pasur për qëllim zhvillimin e zonës në të cilën gjendeshin edhe godinat e Teatrit Kombëtar, Këshilli i Ministrave, pavarësisht këtij fakti, ka miratuar një akt nënligjor me të njëjtin objekt dhe qëllim, duke anashkaluar dhe duke mos u bazuar në këtë ligj.

Në këtë pikëpamje **janë të paqarta arsyet e mungesës së nismës për rishikimin e ligjit Nr.37/2018 dhe të vijimit të procedurave në mënyrë koherente.** Është e vërtetë se organet kushtetuese, me kompetenca në nxjerrjen e akteve normative ose individuale, kanë hapësirën e tyre të vlerësimit për rregullimin e çështjeve në kompetencë të tyre, por në zgjedhjen e instrumentit ligjor ato duhet të respektojnë shtetin e së drejtës, të garantojnë koherencën e rendit juridik dhe hierarkinë e normave të tij.

Sipas Gjykatës, në kushtet kur ligji Nr.37/2018 në nenin 4 të tij ka përcaktuar se në dispozicion të zhvillimit të projektit vihen pasuritë e paluajtshme në pronësi shtet, sipas parashikimeve të tij, Kodit Civil dhe legjislacionit për pronat e paluajtshme, edhe pse ai nuk përmban ndonjë delegim të shprehur për ekzekutivin në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se **miratimi i të njëjtave rregullimeve me dy akte me vlerë të ndryshme ligjore, pa asnjë referencë të njëri-tjetri, jo në kuptimin formal, por në substancë, nga dy organe të ndryshme, cenon parimin e hierarkisë së akteve ligjore dhe krijon, gjithashtu, pasiguri dhe paqartësi në zbatimin e këtyre normave juridike.**

Nga ana tjetër, Gjykata rithekson rëndësinë që ka në një shtet të së drejtës që pushtetet dhe organet e pavarura kushtetuese, përfshirë edhe ato që marrin pjesë në procesin ligjvënës, siç janë Këshilli i Ministrave si organi propozues i projektligjeve dhe Kuvendi si organi ligjvënës, në funksion të koherencës së sistemit ligjor, të veprojnë **duke zbatuar parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, si dhe të bashkëveprojnë me njëra-tjetrën, në respekt të parimit të luajalitetit kushtetues dhe në drejtim të rivendosjes së funksioneve reciproke.**

Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se në miratimin e VKM-së Nr.377/2020 **Këshilli i Ministrave duhet të kishte vlerësuar objektivisht edhe pajtueshmërinë e tij në substancë me parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi dhe veçanërisht me rregullimet e ligjit Nr. 37/2018.**

Referuar sa parashtruar më sipër, në zbatim të Vendimit Nr.29 datë 02.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese, ku referuar arsyetimit të Gjykatës janë shpallur antikushtetues si Ligji Nr.37/2018

ashtu dhe VKM-ja Nr.377/2020 **duke i kthyer palët ne gjëndjen e mëparshme** (para transferimit të pronës), nga ana e Ministrisë së Kulturës,

KËRKOJMË:

- Nisjen e procedurave për RIKTHIMIN e pronës, **pasuria Nr. 1/241 me emërtimin “Teatri Kombëtar”, për sipërfaqen prej 5.522,7 m2, nga Bashkia Tiranë te Ministria e Kulturës;**
- Marjen në dorëzim nga ana e Ministrisë së Kulturës të pronës, **pasuria Nr. 1/241 me emërtimin “Teatri Kombëtar”, për sipërfaqen prej 5.522,7 m2,** nga Bashkia Tiranë dhe duke qënë se ka diferenca materiale:
 - Nisjen e procedurave ligjore **për shpërblimin e dëmit ndaj personave përgjegjës Erion Veliaj etj., për vlerën e Godinave të Teatrit Kombëtar dhe atij Eksperimental** sipas inventarëve kontabël që disponohen nga ana e drejtorisë së Teatrit Kombëtar dhe Eksperimental ashtu edhe të Ministrisë së Kulturës;
 - Nisjen e procedurave ligjore **për shpërblimin e dëmit ndaj personave përgjegjës Erion Veliaj etj., për vlerën e garderobës, arkivës, rekuizitave dhe skenografive të Teatrit Kombëtar dhe atij Eksperimental** sipas inventarëve kontabël që disponohen nga ana e drejtorisë së Teatrit Kombëtar dhe Eksperimental ashtu edhe të Ministrisë së Kulturës;
- Nisjen e procedurave ligjore duke i kërkuar dhe detyruar Agjensinë Shtetërore të Kadastrës **për të kryer transkriptimet e nevojshme në lidhje me rregjistrimin e pronës pasuria Nr. 1/241 me emërtimin “Teatri Kombëtar”, për sipërfaqen prej 5.522,7 m2,** në emër të Ministrisë së Kulturës, duke bërë edhe korigjimin në lidhje me sipërfaqen e Godinës së Teatrit Eksperimental e cila është prishur pa qënë e rregjistruar në ASHK si pronë e Bashkisë Tiranë;
- Nisjen e procedurave ligjore me Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, **për të anuluar fondin e aprovuar nga Buxheti i Shtetit për vitin 2021 sipas Aktit Normativ Nr.22 datë 22.06.2021, në lidhje me fondin për fillimin e punimeve për ndërtimin e Teatrit të Ri;**
- Nisjen e procedurave ligjore duke i kërkuar dhe detyruar Këshillin Kombëtar të Territorit **anullimin e lejes së ndërtimit dalë mbi një projekt korrptiv si ai i Biarke Ingels, pa garë dhe në shkelje të gjithë dispozitave ligjore për zhvillimin e tenderave** (fakt për të cilin kemi disponuar me një kallëzim penal pranë SPAK më datë 13.07.2020);

- Nisjen e procedurave ligjore duke i kërkuar dhe detyruar Këshillin e Ministrave për **RINDËRTIMIN e TEATRIT KOMBËTAR**, në zonën që i korespondon pronës pasuria Nr. 1/241 me emërtimin “Teatri Kombëtar”, për sipërfaqen prej 5.522,7 m², sipas argumentimeve të Gjykatës Kushtetuese në Vendimin Nr.29 datë 02.07.2021, lidhur me vlerat e trashëgimisë kulturore dhe të identitetit kombëtar si dhe referuar rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, **në të njëjtin stil dhe pamje arkitektonike që ka pasur, me të njëjtat volume dhe me të njëjtin projekt si ai fillestar i vitit 1938.**

Çdo përpjekje nga ana juaj për të mos ekzekutuar Vendimin Nr.29 datë 02.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese, **do konsiderohet nga ne si veprim me dashje për pengimin e ekzekutimit të një vendimi gjykatë, veprim i cili në referim të dispozitave ligjore sanksionohet si vepër penale.**

Sipas Nenit 320 të Kodit Penal, është parashikuar se:

“Fshehja, tjetërsimi, konsumimi, dëmtimi apo shkatërrimi i sendeve për të cilat është marrë një vendim prej gjykatës, ose kryerja e veprimeve të tjera të bëra me qëllim që të mos ekzekutohet ose të pengohet ekzekutimi i vendimit gjyqësor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.

Po kështu, sipas Nenit 320 gërma “a”, është sanksionuar se:

“Mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i një vendimi penal ose civil të gjykatës, nga punonjësi i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet. Kur kjo vepër kryhet me qëllim fitimi ose çdo interes tjetër të dhënë ose të premtuar, si dhe për të favorizuar persona që kanë interes për mosekzekutimin e vendimit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”.

Shpallja antikushtetues i VKM-së Nr.377/2020, vendim ky i propozuar **nga Ministria e Kulturës Margariti**, lidhur me transferimin e pronës nga Ministria e Kulturës te Bashkia Tiranë, vërtetoi të gjitha dyshimet tona të arsyeshme dhe të gjithë akuzat e ngritura prej nesh pranë SPAK, lidhur me interesa korruptive dhe kriminale që kanë shoqëruar rekomandimet dhe transferimin e pronës.

Në këto kushte, **mendojmë se është në interes të mbarë të publikut të gjërë** (edhe në raport me mosrëndimin e mëtejshëm të veprave penale të konsumuara nga ana e Ministres Margariti), **EKZEKUTIMI DREJTË DHE NË KOHË I VENDIMIT NR.29 DATË 02.07.2021 TË GJYKATËS KUSHTETUESE.**

Tiranë më datë, 28.07.2021.

KËRKUES:

1. **Edmond Budina**, i biri i Janaq dhe Lirika, i datëlindjes 21 Mars 1952., lindur dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti F20321086S me adresë: Rr.Myslym Shyri P.51, Shk 2 Ap 41.
2. **Adriana Tolka**, e bija e Apostol dhe Afori i datëlindjes 13 Qershor 1977, lindur dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti H75613057O me adresë: Rr. 4 Dëshmorët, Nr 127.
3. **Neritan Liçaj**, i biri i Zijait dhe i Ylvies, i datëlindjes 28.01.1969, lindur dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti G90428142K me adresë: Rr. Myslym Shyri, P.6 Ap.3.
4. **Mehdi Malka**, i biri i Bastriut dhe i Dikes, i datëlindjes 20.03.1952, lindur ne Memaliaj dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti F20320047Q me vendbanim Rr: “Medar Shtylla”, Pallatet “Haëai”, Kulla 6, Tiranë.
5. **Julinda Emiri**, e bija e Kujtimit dhe e Drites, e datëlindjes 25.01.1991, lindur dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti J15125052P.

6. **Robert Budina**, i biri i Janaq dhe Lirika, i datëlindjes 19.06.1964, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti G40608123U.
7. **Adriana Kalaja**, e bija e Muharremit dhe e Fatbardhes, e datëlindjes 13 Tetor 1964, lindur dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti G46013110B me adresë: Rr. Bedri Dedja, Nr 179.
8. **Astrit Seranaj**, i biri i Barjamit dhe Keze, i datëlindjes 16.08.1972 , lindur ne Fier dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti H20816052D me adresë: Rr.Don Bosko, P. Adaro, Ap.1.
9. **Fran Ndoj** , i biri Gjergjit dhe i Dilës, i datëlindjes 02.06.1968, lindur ne Rreshen dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti G80602070Z.
10. **Saimir Dervishi**, i biri Aliut dhe i Qanies, i datëlindjes 02.021968, lindur dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti G80202184J me adresë: Rr.Myslym Shyri, P.47, Sh.1, Ap.13.
11. **Gentiana Maçi**, e bija e Sulejmanit dhe e Nailes, e datëlindjes 11.02.1982, lindur dhe banuee në Tiranë , me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti I25211081H me adresë: Rr. “Ferrit Xhajko”, P.27, Ap.4.
12. **Gentjan Hasani**, i biri Lavdosh dhe i Qanies, i datëlindjes 08.04.1973, lindur dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti H30408090K me vendbanim Tiranë.

13. **Aleksandër Gjonaj**, i biri i Gjonit dhe i Luçisë, i datëlindjes 06.02.1949, lindur dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti E90206088I me vendbanim Rruga “Brigada VIII”, Nd.19, H.3, Ap.24, Tiranë.
14. **Pranvera Skuqi**, e bija e Alushit dhe e Bedries, e datëlindjes 17.02.1957, lindur dhe banuese në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti F75217085C me adresë: Rr. “Prokop Myzeqari”, P.30/3, Ap.15, Tiranë.
15. **Syrja Xhani**, i biri i Hysenit dhe Shyqyries, i datëlindjes 10.07.1954, lindur dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti F40710210M me vendbanim Tiranë.
16. **Liljana Xhabafti**, e bija e Seitit dhe e Begliess, e datëlindjes 10.03.1953, lindur dhe banuese në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti F35310080S me adresë: Rruga Dibrës, Nr.94/1, Tiranë.
17. **Fatos Paçrami**, i biri i Skenderit dhe i Melihasë, i datëlindjes 11.04.1955, lindur dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti F40411042G me vendbanim Lagja “Saraçve”, Nr.176 Tiranë.
18. **Bashkim Bejleri**, i biri i Dervishit dhe i Bukurijes, i datëlindjes 01.10.1946, lindur dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti E61001099R me vendbanim Bulevardi “Zogu i Pare”, P.32, Sh.3, Ap.31 Tiranë.
19. **Donald Martini**, i biri Osmanit dhe i Sanijes, i datëlindjes 17.08.1968, lindur në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti G80817042G me vendbanim rruga “Ali Demi” Nr.187 Tiranë.

20. **Arjeta Bega**, e bija e Ismailit dhe e Fatimes, e datëlindjes 27.07.1954, lindur dhe banuese në Tiranë , me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti F457227073S me adresë: Rruga Thanas Ziko, Pallati Nr.65/1, Shk.1, Ap.10, Tiranë.
21. **Pandi Nasho**, i biri i Thanasit dhe i Ollgës, i datëlindjes 02.11.1958, lindur dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti F81102080P me vendbanim Rr: “Petro Nini Luarasi”, P.10/1 Ap.16 Tiranë.
22. **Luan Kurti**, i biri i Mynyr dhe i Irfames, datëlindjes 17.02.1949, lindur dhe banuese në Tiranë , me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me nr. Personal Identiteti E90217071A me adresë: Rruga Ferit Xhajko, Nr.11, Ap.10, Tiranë.